



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-P-042 të datës 08.06.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-P-040 të datës 08.06.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
2. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020 - 2024.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2020 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit të inkorporojë në Program komentet e Komisionit Evropian.
5. Obligohet Zyra e Kryeministrit që gjatë vitit, sipas nevojës, të inkorporojë në Program veprimet pasuese të dala nga konkluzionet e takimeve të raundit më të fundit të organeve të Stabilizim-Asociimit të themeluara me MSA.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të përcjellë këtë Program për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 8 dhe 44 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të objekteve të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) e të cilat preken nga realizimi i projekteve: ndërtimi i Parkut që do të shërbejë për amfiteatrin e fshatit Mushtisht dhe ndërtimi i "Çerdhes së fëmijëve dhe këndi për të moshuarit" në fshatin Studentçan, Komuna e Suharekës, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të objekteve do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Kompensimi i vlerës së pronave, shpenzimet e procedurës së shpronësimin dhe vlerësimit do të bëhen nga Komuna e Suharekës në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), konform legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimin, Komuna e Suharekës, Ministria e Financave dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4 dhe 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronës së paluajtshme e cila preket nga Restaurimi dhe Konzervimi i Objektivit "Shtabi i UÇK-së në Kosterç", Komuna Skenderaj, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të objekteve të vjetëruara do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Kompensimi i vlerës së pronës, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4 dhe 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronës së paluajtshme private e cila preket nga ndërtimi i "Shiritit për Rreshtim" për hyrje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Rruga Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Zona Kadastrale: Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të objekteve të vjetëruara do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Komuna e Prishtinës.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 285,000.00 € (dyqind e tetëdhjetë e pesëmijë euro) përkatësisht kompensimin e dëmit prej 25% të shumës së saj në vlerë prej 71.000,00 € (shtatëdhjetë e një mijë euro) për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë bujqësore nga fatkeqësitë natyrore elementare në Komunën e Suharekës.
2. Mjetet financiare të ndara nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga fondi rezervë për dëmet eventuale në bujqësi.
3. Mjetet e ndara financiare iu ndahen komunës nga pika 1. të këtij vendimi, në shumën e dëmeve prej 25%, në vlere prej 71.000,00 € (shtatëdhjetë e një mijë euro) duke u bazuar në raportin e dërguar nga Komuna e Suharekës me Nr. 124, të datës 08.06.2020 të Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komuna përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/14

Datë: 14.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me nr. prot. 542 datë 10.07.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Agim Veliu, emërohet Koordinator Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
  - 2.1. Përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me çështjet e luftimit të terrorizmit dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.2. Këshillon Kryeministrin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e terrorizmit, dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin;
  - 2.3. Koordinon aktivitetet e të gjitha institucioneve relevante në çështjet e luftimit të terrorizmit dhe masave kundër ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.4. Koordinon, monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e dokumenteve strategjike të luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.5. Pranon raporte informuese nga institucionet relevante, me qëllim të përgatitjes së dokumenteve strategjike analitike lidhur me luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm;
  - 2.6. Është përgjegjës dhe pikë kontakti ndër-institucional dhe ndërkombëtar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë koordinimin e organizimeve, donacioneve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare;
  - 2.7. Koordinon të gjitha raportimet rreth përgjegjësisë dhe obligimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës në nismat rajonale dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjen e luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
3. Mandati i të emëruarit nga pika 1 e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Koordinatori Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit dhe institucionet relevante për zbatimin e këtij vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë